



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 245/4 Prot.

Tiranë, më 26. 02. 2026

### V E N D I M

#### Nr. 45, datë 26. 02. 2026

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr.40 Regj., datë 05.02.2026 të z. J. P., kundër Kontrollit të Lartë të Shtetit, në të cilën pretendon diskriminim për shkak të “bindjes politike<sup>1</sup>” dhe “përkatësia në një grup të veçantë<sup>2</sup>”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>3</sup>,

### K O N S T A T O I:

#### **I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Subjekti ankues, z. Jovan Plaku në shpjegimet e paraqitura para Komisionerit, është shprehur se: *I. Unë, J. P., ish-Auditues në Kontrollin e Lartë të Shtetit (KLSH), paraqes këtë kërkesë për shkak të një trajtimi të përsëritur dhe sistematik diskriminues nga drejtuesi i institucionit, i cili është materializuar përmes: transferimeve të pajustificuara; vlerësimeve të padrejta dhe të paarsyetuara; izolimit profesional dhe mosangazhimit në detyra; refuzimit të lejeve ligjore dhe largimit të pajustificuar nga shërbimi civil.*

*Këto veprime janë ushtruar në një kontekst të qartë paragjykimi lidhur me origjinën time familjare, si bir i një qytetari të pushkatuar gjatë regjimit komunist dhe përbëjnë shkelje të nenit 1, 2 dhe 12 të Ligjit nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, të dispozitave të Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe Ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së”.*

<sup>1</sup>Shkak i pretenduar dhe saktësuar me plotësimin e ankesës së administruar pranë Komisionerit me shkresën nr. 245/3 prot., datë 20.02.2026.

<sup>2</sup> Me çdo shkak tjetër, ankuesi ka pretenduar përkatësinë në një grup të veçantë për shkak të origjinës suaj familjare, konkretisht me faktin se jeni fëmijë i një qytetari të pushkatuar gjatë regjimit komunist.

<sup>3</sup> Në vijim do t'i referohemi me akronimin: KMD.

*Kërkoj që Komisioneri të konstatojë diskriminimin dhe të marrë masat përkatëse ligjore, sociale, administrative, penale, etj., sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, neni 32 “Kompetencat”.*

## *II. Karriera profesionale dhe situata në punë*

*Kam mbi 25 vjet përvojë pune në administratën publike dhe mbi 8 vjet përvojë direkte në auditim. Kam qenë pjesë e shumë grupeve auditimi në institucione të ndryshme, kryesisht bashki, dhe gjithmonë kam marrë vlerësime pozitive. Gëzoj statusin e nëpunësit civil që nga data 05.04.2018. Nga qershori i vitit 2017 dhe deri në datën 30.07.2024, kam punuar si Auditues i Parë në Departamentin e Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore, ku prej më shumë se pesë vjetësh kam qenë përgjegjës i grupeve të auditimit dhe jam i realizuar në profesionin tim.*

*Në auditimet e kryera, nuk kam marrë asnjë lloj vërejtje apo koment negativ, megjithëse disa prej tyre janë riaudituar edhe disa herë nga grupe të tjera auditimi. Në shumë raste, kam qenë i angazhuar në disa auditime njëherësh dhe kam punuar me përkushtim deri në orët e mëngjesit për të realizuar objektivat e punës. Kam marrë pjesë në mjaft seminare dhe konferenca të ndryshme me institucionet homologe jashtë vendit, si dhe kam ndjekur rregullisht të gjitha trajnimet ku kam qenë i caktuar.*

*Unë jo vetëm që e konsideroj veten të aftë dhe me kualifikim të lartë për realizimin e detyrave që më janë ngarkuar dhe pozicionet që kam ushtruar, por edhe vlerësimet e punës i kam pasur të mira në vazhdimësi. Edhe në testimin e kryer së fundmi nga burimet njerëzore për vlerësimin e njohurive, kam marrë notë pozitive, ndërkohë që shumica e kolegëve të mi, të cilët ende vazhdojnë punën, janë vlerësuar me notë jokaluese.*

*Përkundër këtij realiteti të provueshëm, nga ana e drejtuesit të institucionit, që nga mesi i vitit 2024 është dirigjuar një proces denigrimi, i cili nuk shpjegohet dot me probleme të performancës në punë.*

*Në vlerësimin periodik 6-mujor për periudhën 01.07.2024–31.12.2024, nga zyrtari raportues u vlerësua me notën 3 (kënaqshëm). Në këtë vlerësim ndërhyri jashtë procedurës Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, z. A. Sh., i cili, duke vepruar në këmbë të zyrtarit kundërfirmues, më vlerësoi me notën 4 (jo kënaqshëm), pa dhënë absolutisht asnjë argument apo shpjegim.*

*Pas kërkesës sime për rivlerësim sipas procedurës ligjore, me shënimin “Është subjektiv dhe i paargumentuar”, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, z. A. Sh., këtë radhë me cilësinë e tij si zyrtar autorizues, vendosi shënimin “Mbasi shqyrtova kërkesën për rivlerësim, konfirmoj vlerësimin e dhënë”, sërish pa dhënë asnjë argument apo shpjegim.*

*Në rastin tim, vlerësimi i punës duhet të bëhej nga tre zyrtarë raportues sipas periudhave dhe detyrave që kam pasur, konkretisht z. B. D., znj. J. T., dhe z. R. Xh., i cili duhet të bënte vlerësimin tim si zyrtar raportues, pasi ka qenë personi që mbikëqyrte punën time (të cilit i kam dorëzuar punën time, aktet e konstatimit dhe verifikimit) në Bashkinë Tiranë, ku kam punuar*

*për pjesën më të madhe gjatë periudhës 01.07.2024–31.12.2024. Ky zyrtar raportues nuk ka pranuar të nënshkruajë vlerësimin jorealist të kolegëve.*

*Me shkresën nr. 188/12 prot., datë 29.01.2025, nënshkruar nga Kryetari i KLSH-së, nga Auditues i Lartë në Departamentin e Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore, u transferova në pozicionin Auditues i Parë në Departamentin e Auditimit të Performancës, në kundërshtim me Ligjin për KLSH-në dhe ligjin për nëpunësin civil.*

*Për këtë pozicion të ri pune, nuk jam trajnuar nga KLSH, në kundërshtim me Ligjin nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar, neni 62 “Vlerësimi në punë”, pika 2/1, dhe Rregulloren e Brendshme mbi Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, miratuar me Vendimin nr. 197, datë 12.10.2022 të Kryetarit të KLSH-së, neni 7 “Edukimi dhe Kontrolli i Vazhdueshëm Profesional”.*

*Në vlerësimin periodik 6-mujor për periudhën 01.01.2025–30.06.2025, nga zyrtari raportues, Drejtori i Departamentit të Auditimit të Performancës, z. Aulent Guri, u vlerësova me notën 3 (kënaqshëm). Pavarësisht se nuk ishte negativ, ky vlerësim ka qenë subjektiv dhe i paargumentuar, pasi gjatë kësaj periudhe nuk kam qenë i angazhuar në pothuajse asnjë auditim.*

*Për periudhën 15.01.2025 deri 05.06.2025, në Departamentin e Auditimit të Performancës kam qenë caktuar si shtesë në grupin e auditimit për auditimin me temë “Roli dhe efektiviteti i oficerëve të sigurisë në shkolla”, përkatësisht nga data 13.03.2025 deri në datën 08.04.2025, ku nuk më është caktuar absolutisht asnjë detyrë, madje nuk më është kërkuar as nënshkrimi i dokumentit “Ndarja e detyrave”, i cili është thelbësor për fillimin dhe kryerjen e auditimit.*

*Nga data 05.06.2025 deri në datën 14.07.2025 jam caktuar në grupin e auditimit për auditime financiare në bashkitë Krujë, Pukë dhe Klos, për të cilat nuk mund të më bëhej vlerësim, pasi deri në datën e kryerjes së vlerësimit kishte përfunduar vetëm periudha e auditimit në terren dhe materialet e auditimit nuk kanë kaluar kontrollin e cilësisë.*

*Për periudhat 15.01.2025–13.03.2025 dhe 08.04.2025–05.06.2025 nuk kam qenë i angazhuar në absolutisht asnjë detyrë, por kam qenë i detyruar të rrija në zyrë dhe prezenca ime, veç kamerave, monitorohej edhe fizikisht disa herë në ditë.*

*Edhe në këtë vlerësim, Zyrtari Kundërfirmues nuk e ka nënshkruar formularin, pasi në KLSH pozicioni i Drejtorit të Përgjithshëm vazhdon të jetë vakant dhe nuk ka një person tjetër të autorizuar apo të deleguar për ta përmbushur këtë procedurë sipas përcaktimeve ligjore.*

*Sërish, Zyrtari Autorizues (Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, z. A. Sh.) më ka vlerësuar me notën 4 (jo kënaqshëm), pa dhënë absolutisht asnjë argument apo shpjegim, por është mjaftuar me shënimin “E vlerësoj 4 (jo kënaqshëm) për mungesë të theksuar në komunikim dhe në plotësimin e detyrave në auditim”.*

*Pas kërkesës sime për rivlerësim sipas procedurës ligjore, nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, z. A. Sh., është vendosur shënimi “Mbasi u njoha me kundërshtimin e vlerësimit nga z. J. P., pa shoqëruar me arsyetim, e konfirmoj vlerësimin e dhënë”.*

*Në të dy vlerësimet, z. A. Sh., është në konflikt të pastër interesi, sepse ka bërë vlerësimin si zyrtar kundërfirmues, në vend të Drejtorit të Përgjithshëm, por edhe si zyrtar autorizues, krahas mosrespektimit të procedurës së vlerësimeve.*

*Në bazë të dy vlerësimeve (të jashtëligjshme), me shkresën nr. 802 prot., datë 25.07.2025, nënshkruar nga Drejtori i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore në KLSH, znj. E. H., u lirova nga Shërbimi Civil dhe me shkresën nr. 802/1 prot., datë 25.07.2025, nënshkruar nga Kryetari i KLSH-së, u pushova nga puna dhe m'u ndërpreu marrëdhëniet financiare.*

*Sa më sipër, janë veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 37 “Statusi i punonjësve dhe rregullat etike”, pika 1; Ligjin nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, nenet 25 “Lëvizja paralele në kategorinë ekzekutive” dhe 26 “Plotësimi i vendeve të lira në kategorinë e ulët apo të mesme drejtuese”; VKM-në nr. 242, datë 18.03.2015, e ndryshuar me VKM-në nr. 748, datë 19.12.2018 “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”; VKM-në nr. 243, datë 18.03.2015, e ndryshuar me VKM-në nr. 746, datë 19.12.2018 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, si dhe “Rregullores së Brendshme mbi Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, miratuar me Vendimin nr. 197, datë 12.10.2022 të Kryetarit të KLSH-së, neni 6 “Statusi i punonjësve”.*

*Krahas sa më sipër, në datën 15.04.2025, ndërkohë që nuk isha i angazhuar në absolutisht asnjë auditim dhe isha i detyruar të rrija në zyrë, nëpërmjet email-it, i kam kërkuar Drejtorit të Departamentit, z. A. G., 2 ditë leje nga leja e zakonshme e pakryer gjatë vitit 2024, përkatësisht datat 15 dhe 16 prill, me “cc” Drejtorit të BNj, znj. E. V.*

*Ndërkohë që z. G., e miratoi, normalisht dhe sipas akteve ligjore në fuqi, znj. H., po atë datë, nëpërmjet email-it, i ka tërhequr vëmendjen atij dhe me “cc” mua, duke cilësuar se: “1. Afati për kryerjen e lejes së vitit 2024 ka përfunduar në 31.03.2025. Për lejet e kryera pas këtij afati duhet të keni të miratuar refuzimin që i është bërë nëpunësit për pamundësinë e kryerjes së lejes brenda datës 31.03.2025, që nënkupton miratim për kryerjen e saj pas kësaj date.*

*2. Ndarja e lejes në më pak se 5 ditë duhet të jetë vetëm në raste të veçanta dhe jo një praktikë e përsëritur.”*

*Për sa më sipër, znj. H., i referohet VKM-së nr. 568, datë 06.10.2021, e ndryshuar, dhe Dokumentit të Politikave të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore.*

*Në datën 17.04.2025, i kam kthyer përgjigje znj. H., dhe në “cc” znj. V. G., Sekretare e Përgjithshme, dhe z. A. G., duke iu cilësuar se sa shprehet znj. H., nuk bazohet në VKM-në në*

*fjalë, ndërsa Dokumenti i Politikave të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore nuk është i përditësuar sipas VKM-së nr. 568, datë 06.10.2021 “Për miratimin e rregullave për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit, orët shtesë dhe kompensimin e tyre në institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore”, konkretisht kapitulli III “Pushimet”, pika 4.*

*Nga asnjëri prej tyre nuk kam marrë përgjigje. Lejen e kam kërkuar për të shoqëruar nënën time 90-vjeçare gjatë vizitave spitalore.*

*Në datën 12.06.2025, kam takuar Drejtorin e Departamentit, z. Guri, dhe kam biseduar me të për një javë leje të zakonshme nga leja e pakryer e vitit 2024, duke menduar se ishte zgjidhur problemi nga komunikimi me email.*

*Meqë z. Guri nuk mund të shprehej për lejen e prapambetur nga viti 2024, i kërkoja të më jepte leje nga viti 2025, nga e cila nuk kisha konsumuar asnjë ditë, dhe problemin e lejes së pakryer për vitin 2024 do ta bisedoja me Kryetarin e KLSH-së.*

*Nëpërmjet email-it, z. Guri shprehet se “e kishte dakordësuar lejen time për vitin 2025 dhe do ta kalonte për miratim te Kryetari”.*

*Në datën 13.06.2025, nëpërmjet asistentes, i kërkoja takim z. A. Sh., i cili më priti brenda ditës, në orën 14:00.*

*Pasi i shpjegova situatën familjare dhe arsyet e kërimit të lejes, i shpjegova edhe për korrespondencën e zhvilluar me znj. H. Më tha se ishte në dijeni dhe këmbënguli që afati për kryerjen e lejes së zakonshme të pakryer përfundonte në datën 31 mars të vitit pasardhës.*

*Megjithëse i përmenda ndryshimet e fundit ligjore, nuk ndryshoi mendim, por më tha edhe se kishte vendosur që i gjithë personeli i KLSH-së do ta kryente lejen e zakonshme gjatë muajit gusht.*

*Megjithëse i shpjegova sërish arsyet e mia dhe se nuk e doja lejen e zakonshme me ditë të shkëputura për pushime, por për nevoja familjare, kryesisht shëndetësore, përsëri më refuzoi.*

*Më refuzoi edhe kur i kërkoja leje pa të drejtë page dhe nuk e pranoi që për disa persona kishte miratuar lejen e zakonshme edhe jashtë muajit gusht, por edhe lejen e pakryer të vitit të kaluar.*

*Pavarësisht diskutimit për refuzimin e lejes së zakonshme të pakryer nga viti i kaluar, me argumentin se afati për kryerjen e lejes së zakonshme të pakryer përfundonte në datën 31 mars të vitit pasardhës, në vendimin për lirimin nga puna, z. A. Sh., kishte përllogaritur edhe lejen e pakryer për vitin 2024.*

### *III. Rrethanat historike dhe prejardhja familjare*

*Babai im, K. P., inxhinier nafte, u ekzekutua me pushkatim më 28 qershor 1976 si i dënuar politik. Ky fakt është publik dhe pjesë e dokumentuar e historisë sime personale. Përkushtimi im për kërkimin e të vërtetës mbi fatin e tij është bërë i njohur edhe përmes publikimeve dhe konferencave ndërkombëtare.*

*Në këtë kontekst, unë besoj se trajtimi ndaj meje është ndikuar nga paragjykime lidhur me këtë prejardhje, gjë që përbën diskriminim për shkak të origjinës familjare dhe historisë së persekutimit politik.*

#### *IV. Paralele dhe analogji me presionin psikologjik dhe persekutimin e babait tim*

*Në nëntor 1975, babai im u dekorua me titullin “Urdhri i Republikës” për kontributin e tij teknik dhe shkencor që në vitin 1974, prodhimi i naftës në Shqipëri arriti në 2.2 milionë ton naftë bruto, kryesisht nga puna e tij me zbulimin e vendburimit të Gorishtit.*

*Në korrik 2024, pa kërkesë nga unë dhe në kundërshtim me ligjin “Për Nëpunësin Civil”, ligjin “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit” dhe “Rregulloren e Brendshme në KLSH”, u ngrita në detyrë, nga Auditues i Parë në Auditues i Lartë, në të njëjtin departament.*

*Në mars 1975, babai im u arrestua me akuza të fabrikuara për “agjitacion e propagandë, sabotim dhe tradhti ndaj atdheut” dhe iu hoqën të gjithë titujt dhe funksionet.*

*Nëna, bashkë me mua 9-muajsh, u nxorëm nga shtëpia, u internuam dhe u konfiskua çdo gjë e mundshme, nga mobiljet, rrobat e trupit e fotografitë, deri te librat dhe grepat e peshkimit.*

*Në janar 2025, u shkarkova nga pozicioni “Auditues i Lartë” në Departamentin e Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore dhe u transferova në pozicionin “Auditues i Parë” në Departamentin e Auditimit të Performancës, në kundërshtim me legjislacionin e përmendur më sipër.*

*Në vlerësimin periodik 6-mujor, për periudhën korrik–dhjetor 2024, nga Kryetari i KLSH-së u vlerësua negativisht me notën 4, pa asnjë argument dhe pa asnjë shkak të ligjshëm, pavarësisht se nga drejtorët me të cilët kisha punuar gjatë asaj periudhe (zyrtarët raportues) isha vlerësuar pozitivisht.*

*Nga 25 marsi 1975 deri në maj 1976, u zhvillua procesi hetimor ndaj babait tim, i shoqëruar me të gjitha presionet psikologjike dhe torturat e mundshme si pjesëtar i grupit armiqësor në naftë dhe filloi persekutimi për familjen time.*

*Nga data 15.01.2025 deri në datën 13.03.2025, nuk më është caktuar absolutisht asnjë detyrë dhe jam lënë të rri i vetëm në zyrë.*

*Nga data 13.03.2025 deri në datën 08.04.2025, jam caktuar në grupin e auditimit të performancës me temë “Roli dhe efektiviteti i oficerëve të sigurisë në shkolla”, ku përsëri nuk më është caktuar asnjë detyrë dhe pothuajse gjatë gjithë kësaj periudhe kam ndenjur vetëm në zyrën e caktuar pranë institucionit që auditohej.*



*Nga data 08.04.2025 deri në datën 05.06.2025, përsëri nuk më është caktuar absolutisht asnjë detyrë dhe jam lënë të rri i vetëm në zyrë.*

*Gjatë kësaj periudhe, për shkak të ngarkesës, shumë nga kolegët e mi dhe sidomos ata në nivelin tim profesional kanë qenë të angazhuar në disa grupe auditimi njëherësh.*

*Kjo periudhë izolimi nga kolegët, nga puna, nga detyrat e mia funksionale, më është dukur si biruca nr. 47, ku mbahej i burgosur babai im para se të ekzekutohej. Dalja në një auditim pa absolutisht asnjë detyrë më është dukur thjesht si ndërrim i birucës ku duhej të qëndroja deri në përfundim të hetimeve për “agjitacion e propagandë, sabotim dhe tradhti ndaj atdheut”.*

*Gjatë gjithë zhvillimit të hetimeve, pyetjet që i bëheshin babait tim ishin të llojit “...flisni i pandehur për veprimtarinë tuaj armiqësore...” apo “...flisni i pandehur si e keni sabotuar Vendimin e Byrosë Politike...”.*

*Gjatë të gjitha takimeve që kam pasur me z. A. Sh., të gjitha bisedat apo pyetjet e bëra prej tij kanë qenë “çfarë ke bërë ti...” apo “...me kë ke komunikuar ti...”, duke më sjellë gjithmonë ndërmend peshën e akuzave të tim eti për agjitacion e propagandë, sabotim dhe tradhti ndaj atdheut.*

*Asnjëherë z. A. Sh., nuk ka pyetur për ecurinë e punës me qëllim përmirësimin e saj, por vetëm me synimin për gjetjen e “veprimtarisë armiqësore” në auditim.*

*Gjatë zhvillimit të hetimeve, në qershor 1975, babait i ka shkuar në burg Kadri Hazbiu, ish-ministër i Brendshëm në atë kohë.*

*Ndërkohë, nënës sime i kishin kërkuar që po atë ditë të paraqitej në burgun ku mbahej im atë, detyrimisht bashkë me mua që sapo kisha mbushur vitin.*

*Nëna më ka treguar se unë sapo kisha filluar të ec dhe gjatë kohës që priste në oborrin e burgut, pa ditur se për çfarë, hetuesit i kanë kërkuar të më lërë mua të endem nëpër oborrin e burgut.*

*Shumë vite më pas, kur jam takuar me ish-hetuesit e babait tim në kërkim të eshtrave të tij, kam mësuar nga disa prej tyre, të cilët kanë qenë të pranishëm, se babain tim e kishin nxjerrë në dritaren e birucës që të na shikonte mua dhe nënën në oborrin e burgut. Kjo kërkesë ishte bërë nga ish-ministri Hazbiu për t'i bërë presion psikologjik babait tim që të pranonte akuzat, duke e kërcënuar “...po nuk pranove akuzat, do të të vrasim djalin dhe gruan...”.*

*Kjo situatë, duke më kujtuar momentin kur i bënin babait tim presion psikologjik, duke i kërkuar të më shikonte mua l vjeç duke vrapuar nëpër oborrin e burgut, më bëri që të përjetoja shqetësime shëndetësore dhe mendore, si më poshtë:*

*Në datën 15.02.2025, i kam marrë leje drejtorit, z. Aulent Guri, sepse nuk ndjehesha mirë. Kam shkuar në urgjencën e Spitalit Ushtarak dhe pas vizitës, u diagnostikova me çrregullim ankthi. Pas rekomandimeve të mjekut përkatës, u vizitova nga mjeku i familjes dhe bëra konsulta nga*

*mjeku kardiolog dhe psikiatër. Për këtë shkak, pas përfundimit të ekzaminimeve, u trajtova me dy javë pushim dhe mjekimet përkatëse, konkretisht nga data 26.02.2025 deri më 05.03.2025.*

*E njëjta situatë më është përsëritur në momentin kur më u refuzua kërkesa për leje dhe u trajtova me tetë ditë pushim, nga data 30.06.2025 deri më 08.07.2025, si dhe mjekimet përkatëse. Gjithashtu, kjo situatë ankthi u përsërit edhe pas largimit nga puna, në datën 27.08.2025, ku mora mjekimin dhe rekomandimet përkatëse për të ndjekur problemin në vijimësi.*

*Gjatë kësaj periudhe rifillova duhanin, pas më shumë se 10 vitesh ndërprerje, si dhe fillova të mjekohem për hipertensionin dhe aritminë.*

*Pra, nga sa më sipër, për analogji me pushkatimin e babait tim, më erdhi rradha edhe mua të “pushkatohem”. Pushimi nga puna, në kushtet kur kam dy fëmijë të cilët i prindëroj i vetëm, nënën 90-vjeçare, të sëmurë dhe me pension minimal, një kredi të konsiderueshme dhe faturat e përditshme për të paguar, është pushkatimi më i rëndë që mund të më bënte z. A. Sh. Apo mos vallë priste që edhe unë të tentoja të vras veten, njësoj si babai im në vitin 1975? Kjo është*

Në përfundim, subjekti ankues, ka kërkuar nga Komisioneri:

- Të verifikojë në mënyrë të thelluar dhe të pavarur trajtimin diskriminues ndaj meje në KLSH;
- Të vlerësojë shkeljen sistematike të ligjit për vlerësimet, transferimet, pushimet vjetore dhe largimin nga puna;
- Të konstatojë diskriminimin për shkak të origjinës familjare, bindjeve dhe historisë personale të persekutimit;
- Të ndërmarrë masa ligjore dhe rekomandime konkrete, në përputhje me mandatin e tij, për të parandaluar përsëritjen e këtyre praktikave në një institucion të pavarur kushtetues.

Pas shqyrtimit paraprak të ankesës së depozituar pranë Komisionerit, u konstatua se ajo kishte mangësi të anës formale, në lidhje me shkaqet e pretenduara nga ana e subjektit ankues dhe lidhjen shkakësore, ndërmjet trajtimit më pak të favorshëm dhe shkakut të mbrojtur, në raport me subjektet nga të cilët pretendon se diskriminohet, apo me të drejtën ligjore të saj.

1. Për këtë arsye, nëpërmjet shkresës nr.245/2 prot., datë 09.02.2026, KMD, i ka kërkuar subjektit ankues, si më poshtë vijon:

- Në lidhje me shkakun e pretenduar për diskriminim, ju keni deklaruar se, në cilësinë e “çdo shkakut tjetër”, diskriminimi që pretendoni lidhet me origjinën tuaj familjare, konkretisht me faktin se jeni fëmijë i një qytetari të pushkatuar gjatë regjimit komunist, fakt ky i cili është provuar me dokumentacionin përkatës të depozituar pranë Komisionerit. Megjithatë, nga përmbajtja e ankesës dhe dokumentacioni i administruar nuk rezulton e qartë lidhja shkak-pasojë midis kësaj karakteristike që ju e mbartni dhe veprimeve apo mosveprimeve konkrete të institucionit të Kontrollit të Lartë të Shtetit,



të cilat ju i konsideroni si trajtim diskriminues. Në këto kushte, është e nevojshme të sqaroni në mënyrë të argumentuar se si dhe përmes cilave veprime konkrete kjo origjinë familjare ka ndikuar drejtpërdrejt në trajtimin e pretenduar nga ana e këtij institucioni, duke përshkruar pasojat konkrete që keni përjetuar si rrjedhojë e këtij trajtimi.

- Informacion nëse, i keni adresuar shqetësimet për diskriminimin tek drejtuesi i institucionit nëse po, ju lutemi të na vini në dispozicion kopje e ankesës si dhe përgjigjen e kthyer nga institucioni.
- Informacion nëse këtë çështje po e ndiqni gjyqësisht; nëse po, na vini në dispozicion kopje të kërkesë-padisë së depozituar pranë gjykatës.
- Çdo informacion ose dokumentacion tjetër shtesë që ju do e gjykoni të nevojshëm në mbështetje të ankesës tuaj.

2. Me shkresën nr. 245/3 prot., datë 20.02.2026, është administruar pranë Komisionerit kthim-përgjigjja e ankuesit ndaj kërkesave të parashtruara. Nga analiza e përmbajtjes së saj rezulton se ankuesi nuk ka paraqitur sqarime konkrete dhe të argumentuara mbi lidhjen shkak-pasojë ndërmjet origjinës së tij familjare dhe trajtimit të pretenduar diskriminues; nuk ka depozituar dokumentacion që provon adresimin e shqetësimit pranë drejtuesit të institucionit; si dhe nuk ka dhënë informacion të plotë e të dokumentuar nëse çështja po ndiqet gjyqësisht, duke mos paraqitur kopje të ndonjë kërkesë-padie të depozituar pranë gjykatës. Përmbajtja e shkresës kufizohet kryesisht në ritheksimin e pretendimeve dhe në referime të dispozitave ligjore.

## **II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:**

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”*.

Në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Gjithashtu, diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se viktimat e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur.

*Nga këqyrja e analizimi i dokumentacionit të dërguar pranë KMD-së, rezulton se:*

Nga qershori i vitit 2017, ankuesi, J. P., ka filluar punë në Kontrollin e Lartë të Shtetit, duke ushtruar detyrën e Audituesit të Parë në Departamentin e Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore. Më 05.04.2018, ai ka fituar statusin e nëpunësit civil. Gjatë periudhës qershor 2017-30.07.2024, ankuesi ka kryer detyrat e Audituesit të Parë, duke qenë përgjegjës i grupeve të auditimit dhe duke marrë pjesë në auditime të shumta në institucione të vetëqeverisjes vendore, Në korrik 2024, ai është ngritur në detyrën e Audituesit të Lartë në të njëjtin departament.

Më 29.01.2025, me shkresën nr. 188/12 prot., ankuesi është transferuar nga pozicioni i Audituesit të Lartë në Departamentin e Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore në pozicionin e Audituesit të Parë në Departamentin e Auditimit të Performancës, duke ndryshuar funksionin dhe strukturën organizative të marrëdhënies së tij të punës. Marrëdhënia e punës është ndërprerë më 25.07.2025, me shkresën nr. 802 prot. për lirimin nga Shërbimi Civil dhe me shkresën nr. 802/1 prot. për pushimin nga puna dhe ndërprerjen e marrëdhënieve financiare, duke përfunduar kështu marrëdhënia e punës së ankuesit me institucionin.

Nga shqyrtimi i ankesës së depozituar pranë Komisionerit, rezulton se ankuesi, në fillim, ka pretenduar diskriminim për shkak të “çdo shkakut tjetër”, duke u bazuar kryesisht në origjinën e tij familjare si fëmijë i një qytetari të pushkatuar gjatë regjimit komunist. Me plotësimin e mëvonshëm të ankesës, ai ka saktësuar shkaqet e pretenduara, duke i lidhur ato edhe me bindjet politike dhe me përkatësinë në një grup të veçantë, duke argumentuar se këto karakteristika kanë ndikuar në trajtimin e tij në institucion.

Megjithatë, ankuesi nuk ka paraqitur prova konkrete dhe të dokumentuara që të tregojnë lidhjen shkak-pasojë midis këtyre shkaqeve dhe veprimeve ose mosveprimeve të institucionit, si dhe nuk ka depozituar asnjë informacion që vërteton adresimin e shqetësimeve pranë drejtuesit të institucionit apo ndjekjen gjyqësore të çështjes.

Ankuesi pretendon se ka qenë subjekt i një trajtimi të përsëritur dhe sistematik diskriminues nga drejtuesi i Kontrollit të Lartë të Shtetit, sipas tij, këto veprime nuk lidhen me performancën profesionale, por janë ndikuar nga paragjykimet për shkak të origjinës së tij familjare, konkretisht si bir i një personi të pushkatuar gjatë regjimit komunist, duke përbërë diskriminim për shkak të origjinës dhe historisë së persekutimit politik të familjes.

Komisioneri i ka kërkuar subjektit ankues sqarime dhe dokumentacion shtesë lidhur me ankesën, duke përfshirë: shpjegimin e lidhjes shkak-pasojë midis origjinës së tij familjare dhe trajtimit të pretenduar diskriminues nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, përshkrimin e veprimeve konkrete dhe pasojave të përjetuara; dorëzimin e kopjeve të ankesave dhe përgjigjeve të

institucionit në rast se shqetësimet janë adresuar pranë drejtuesit; informacion nëse çështja po ndiqet gjyqësisht dhe kopjet përkatëse të kërkesë-padive; si dhe çdo dokumentacion tjetër mbështetës që ankuesi do të gjykonte të nevojshëm.

Nga analiza e përgjigjes së ankuesit rezulton qartë se ai nuk ka ofruar asnjë sqarim konkret e të argumentuar mbi lidhjen shkak-pasojë ndërmjet origjinës së tij familjare dhe trajtimit të pretenduar diskriminues, nuk ka depozituar dokumentacion që të provojë se shqetësimet janë adresuar tek drejtuesi i institucionit, dhe nuk ka dhënë informacion të plotë e të dokumentuar nëse çështja ndiqet gjyqësisht, duke mos paraqitur kopje të ndonjë kërkesë-padie të depozituar pranë gjykatës. Përmbajtja e përgjigjes së tij është e kufizuar kryesisht në ritheksimin e pretendimeve dhe referime ligjore, pa prova ose argumente të reja, duke lënë të paqartë bazën konkrete të ankimit për diskriminim.

**Pas analizimit sa më sipër, Komisioneri vlerëson se ankesa nuk duhet të pranohet pasi është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji, bazuar në arsyetimin vijues:**

Në lidhje me pretendimin për diskriminim për shkaqet e sipërcituar, Komisioneri vlerëson se, vetëm fakti që një person posedon këtë shkak, nuk mjafton për të ngritur një pretendim për diskriminim. Personi i cili pretendon se është diskriminuar për shkaqet e pretenduara, por jo vetëm, duhet të paraqtojë fakte e prova mbi të cilat mund të prezumohet se ka një diferencë në trajtim dhe se kjo diferencë në trajtim pretendohet se ka si bazë shkakun e mbrojtur.

Në kuptim të Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i ndryshuar, “përkatësia në një grup të veçantë<sup>4</sup>” përbën një shkak të mbrojtur, i cili synon të garantojë mbrojtje ndaj individëve që identifikohen si pjesë e një kategorie të caktuar shoqërore, historike apo sociale, e dallueshme nga të tjerët dhe potencialisht e ekspozuar ndaj paragjyqimeve apo trajtimit të pafavorshëm. Ky koncept përfshin jo vetëm grupe të përcaktuara qartë në ligj, por edhe kategori që, në varësi të rrethanave konkrete, mund të përbëjnë një “grup të veçantë” për shkak të një karakteristike të përbashkët, siç mund të jetë origjina familjare apo historia e persekutimit politik.

Megjithatë, për të arritur në përfundimin se kemi të bëjmë me diskriminim për shkak të përkatësisë në një grup të veçantë, kërkohet të provohet ekzistenca e një lidhjeje shkak–pasojë ndërmjet kësaj përkatësie dhe trajtimit të pretenduar të pafavorshëm. Pra, nuk mjafton vetëm vetë-identifikimi si pjesë e një grupi; duhet të ekzistojë një element faktik që tregon se vendimmarrja e institucionit është ndikuar nga kjo përkatësi, ose se kjo karakteristikë ka shërbyer si motiv real apo i perceptuar për trajtimin e diferencuar.

Nga shqyrtimi i materialit të paraqitur, rezulton se ankuesi nuk ka ofruar asnjë provë konkrete apo indicie serioze që të krijojnë një prezumim të arsyeshëm se përfundimi i marrëdhënies së punës apo trajtimi i tij në institucion ka ardhur për shkak të origjinës së tij familjare apo historisë së persekutimit politik të familjes. Nuk janë paraqitur deklarime, veprime, dokumente

---

<sup>4</sup> <https://www.kmd.al/shkaqet-e-diskriminimit/>

apo rrethana specifike që të tregojnë se drejtuesi apo struktura e institucionit e kanë marrë në konsideratë këtë element në mënyrë negative apo përjashtuese.

Në kuptim të Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i ndryshuar, “bindja politike<sup>5</sup>” si shkak i mbrojtur nënkupton mbajtjen ose jo të një bindjeje të caktuar politike, shprehjen e pikëpamjeve politike, apo anëtarësinë/mos anëtarësinë në një parti apo organizatë politike, si dhe rastet kur një individ trajtohet në mënyrë të pafavorshme pikërisht për shkak të këtij identiteti apo qëndrimi politik.

Që një pretendim për diskriminim për shkak të bindjeve politike të jetë i bazuar, duhet të ekzistojë një lidhje e qartë shkak-pasojë midis bindjes politike (apo perceptimit për të) dhe masës së marrë ndaj individit. Pra, duhet të provohet ose të paktën të krijohet një prezumim i arsyeshëm se trajtimi i pafavorshëm ka ardhur si rezultat i drejtpërdrejtë i bindjes politike, dhe jo për arsye të tjera objektive.

Pala ankuese nuk parashtroi fakte apo rrethana nga të cilat të mund të prezumohet se ka patur një diferencë në trajtimin ndaj saj nga ana e Kontrollit të Lartë të Shtetit, që të jetë motivuar nga shkaqe të pretenduara si “bindja politike” dhe “përkatësia në një grup të veçantë”.

Nga një vlerësim i përgjithshëm juridik i rrethanave të paraqitura, rezulton se pretendimi i ankuesit J. P., për trajtim diskriminues nga drejtuesi aktual i Kontrollit të Lartë të Shtetit është haptazi i pabazuar dhe i pambështetur në prova apo indicie që do të mund të krijojnë një bazë objektive për konstatimin e cënimit të pretenduar. Edhe pse ankuesi referon ndryshime të herëpashershme të pozicionit të tij, konstatohet se në korrik 2024, gjatë ushtrimit të detyrës nga i njëjti drejtues (*emëruar në vitin 2020*), ai është ngritur në detyrën e Audituesit të Lartë, fakt që objektivisht dëshmon vijimësi të marrëdhënies së punës dhe progres profesional. Pavarësisht pretendimeve të parashtruara, nuk rezulton që ankuesi t’i ketë ankimuar zyrtarisht këto çështje apo ndryshime pozicioni pranë strukturave kompetente të institucionit apo pranë organeve të tjera përkatëse, si dhe nuk ka paraqitur prova apo elementë faktikë konkretë që të mbështesin këto pretendime.

Bazuar në përkufizimin që ligji i bën diskriminimit, jo çdo sjellje e kundërshtuar për paligjshmëri, është një sjellje diskriminuese. Një sjellje diskriminuese në çdo rast është një sjellje e paligjshme, por jo çdo sjellje e paligjshme konsiderohet diskriminuese.

Referuar sa më lart, ankuesi nuk solli prova e fakte mbi të cilat mund të prezumohej se diferenca në trajtim i ka ardhur për shkaqet e pretenduara, si dhe nuk ka sqaruar apo specifikuar në asnjë moment sesi lidhen këto shkaqe (“bindja politike” dhe “përkatësia në një grup të veçantë”.) me pasojat e pretenduara, konkretisht me përfundimin e marrëdhënies së punës. Ai nuk ka paraqitur asnjë element faktik apo provues që të mbështesë ekzistencën e një lidhjeje shkak-pasojë midis origjinës së tij familjare, bindjeve politike dhe përkatësisë në një grup të veçantë, dhe trajtimit të supozuar diskriminues nga ana e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

---

<sup>5</sup> <https://www.kmd.al/shkaqet-e-diskriminimit/>

Në mungesë të një pasqyrimi të qartë dhe të dokumentuar të mënyrës se si këto shkaqe kanë ndikuar drejtpërdrejt në vendimet e marra nga punëdhënësi ndaj i tij, pretendimi për diskriminim mbetet i pambështetur në prova dhe rrethana konkrete.

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se ankuesi është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme, pikërisht për shkak të një karakteristike të mbrojtur. Në rastin e ankuesit, ai nuk ka arritur të paraqesë prova ose fakte konkrete që të mbështesin ekzistencën e një lidhjeje shkak-pasojë midis origjinës së tij familjare, bindjeve politike dhe përkatësisë në një grup të veçantë, dhe trajtimit të supozuar diskriminues gjatë ndryshimeve të pozicioneve dhe detyrave në Kontrollin e Lartë të Shtetit.

Në këto kushte, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi vlerëson se rrethanat e paraqitura nuk evidentojnë elementë që e bëjnë çështjen objekt shqyrtimi në kuadër të juridiksionit material të këtij institucioni, sipas përcaktimeve të legjislacionit për mbrojtjen nga diskriminimi.

Palës ankuese i lind e drejta të ndjekë rrugët e tjera ligjore të parashikuara në legjislacionin për marrëdhëniet e punës dhe shërbimin civil, nëse konsideron se janë cënuar të drejtat e tij në raportin e punës apo në procedurat e ndjekura nga institucioni punëdhënës. Këto rrugë përfshijnë paraqitjen e pretendimeve pranë organeve administrative kompetente sipas legjislacionit të shërbimit civil, si dhe, në mungesë të një zgjidhjeje administrative, ndjekjen e procedurës gjyqësore pranë gjykatave kompetente, me qëllim konstatimin e shkeljeve të pretenduara, rivendosjen në të drejtë apo dëmshpërblimin, sipas parashikimeve ligjore në fuqi.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, bazuar në nenin 33, pika 4, shkronja “ç”, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri arrin në përfundimin se, ankesa e paraqitur nga pala ankuese kundër Kontrollit të Lartë të Shtetit, nuk mund të pranohet, pasi është haptazi e pabazuar dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/ç/dh, të ligjit nr.10 221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I :**

1. Mospranimin e ankesës së subjektit ankues z. J. P., pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.

## **KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**